



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 10, datë 31.07.2023

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10⁰⁰)

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Sokol Kushta | 23.Liljana Breshani |
| 2.Vullnet Bilbilaj | 24.Rajmonda Zoto |
| 3.Edison Kapaj | 25.Besmir Brahimi |
| 4.Ervis Moçka | 26.Elca Bezhani |
| 5.Frosina Qyrdeti | 27.Atird Hoxha |
| 6.Grigor Dede | 28.Klodian Xhyheri |
| 7.Simbol Pazaj | 29.Elpiniqi Mërkuri |
| 8.Simo Petromilo | 30.Bujar Osmanaj |
| 9.Endri Hyseni | 31.Arsen Belaj |
| 10.Roland Strakosha | 32.Alta Haluci |
| 11.Vjola Xhafaj | 33.Dikens Bushaj |
| 12.Ledja Shollaj | 34.Arjan Isufi |
| 13.Brikena Sika | 35.Briseida Çakërri |
| 14.Eglantina Aliaj | 36.Eneida Vera |
| 15.Anisa Ceno | 37.Gjergji Nika |
| 16.Novrus Rrokaj | 38.Geron Gunbardhi |
| 17.Marsela Dashi | 39.Illir Aliaj |
| 18.Edlira Kapllanaj | 40.Jerina Dervishaj |
| 19.Shkëlqim Leskaj | 41.Englantina Imeraj |
| 20.Brikena Puka | 42.Refie Laze |
| 21.Evis Allushi | 43.Aurora Qarri |
| 22.Myzafer Elezi | 44.Lorel Canaj |

Mungojnë :

- 1.Ardian Musta
- 2.Gëzim Çapoj
- 3.Anxhela Shenaj
- 4.Erëmal Arapi
- 5.Liri Dëma
- 6.Eda Begaj
- 7.Mujo Shakaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 10/1, datë 31.07.2023

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Përsëndetje të gjithëve!

I nderuar Kryetar !

Të nderuar këshilltarë! Meqenëse kuorumi është i formuar/plotësuar , si fillim ju njohim me shprehjen e ligjshmërisë.

Me shkresën e ardhur nga prefekti i qarkut Vlorë, vendimet e këshillit bashkiak Nr 53÷55, janë shprehur të ligjshëm.(Lexon)

Vijojmë me votimin e rendit të ditës. Kemi shtuar një projektvendim, e kaluam dhe në mbledhjen e kryesisë, “Për kalimin nga përdorimi në pronësi të tokës bujqësore”

Pra, jeni dakort ta shtojmë ?

Votohet.

Pro -

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Shtohet projektvendimi.

Votohet rendi i ditës.

Miratohet . Të gjithë pro, me projektvendimin shtesë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 10/2, datë 31.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë, për muajin qershor 2023”. Relacion nga administrata .

Znj.Irena Stasa /Drejtoreshë e NSHS – Janë 2 projektvendime që kalojnë çdo muaj , për përfitimin e ndihmës ekonomike. Nga të ardhurat e bashkisë, përfitojnë 30 familje me fondin e akorduar, sipas rajoneve dhe njësive administrative. S’ka familje që hyjnë për herë të parë në skemën e ndihmës ekonomike. Ka familje që dalin nga skema e ndihmës ekonomike për arsye të ndryshme.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pyetje, diskutime ?

Znj.Elca Bezhani /Kryetare e komisionit të financës - Në datën 28 korrik, u mbledh komisioni i financës, ku morri në shqyrtim gjithë projektvendimet me probleme ekonomike financiare. Relacioni i dy projektvendimeve të ndihmës ekonomike, ishte korrekt. Zonja Anxhela, nuk ishte dakort me fondin për familjet në nevojë. Këto 2 projektvendime u miratuan me shumicë votash dhe, për miratim sot në mbledhje.

Znj.Alta Haluci - Pjesa më e madhe e këshilltarëve më njohin. Qëllimi im , nuk ishte të isha zv/kryetare. Por, ne si “BF” jemi 9 anëtarë , ndërsa “PD” me” Vulën e dhuruar “ 3 anëtarë. Gabimi juaj është se, nuk keni vlerësuar votat e qytetarëve. E morrët përsipër për tu bërë me opozitën e vogël. Jemi për të bërë opozitë dhe të gjithë bashkë për Vlorën, për zhvillimin e Vlorës. Për projektvendimin , nuk dimë sa është buxheti, s’kemi listat, kush del nga skema, kush shtohet. Pra, ne duam të dimë saktësisht , ata që kanë nevojë dhe niveli i fondit është shumë i vogël.

Znj.Elca Bezhani - Në komision u diskutuan të gjitha këto , kriteret që zgjidhen familjet, ishin në rregull, pra , zonja zbaton kriteret.

Znj.Irena Stasa – Asnjë përfitues i ndihmës nuk aplikon, është nëpunësi i ndihmës , janë 5 rajone dhe 4 njësi administrative , ata vetëm firmosin. Kryetarja e komisionit e theksoi që, masa e ndihmës nuk varet nga ne. Ne jemi për ata përfitues ,për kushte emergjente, por ata mund të fillojnë dhe punë. Ne jemi drejt tregut të punës , jo asaj parazitare.

Z.Gjergji Nika - Ka shumë vendime dëxhizive për të ecur përpara.Të kthehem tek zgjedhja e zv/kryetarit të këshillit bashkiak. zv/kryetari i këshillit të bashkisë, i takon opozitës . Kanë qenë 2 propozime dhe është votuar.

Në protokoll, sipas listës, vendet ishin ndryshe , herën e kaluar .

I kthehem komisionit të financës., ka qenë shumë efiçient dhe profesional. Drejtorja e ndihmës ekonomike , zbaton vetëm kriteret. Mirë është ti përmbahemi rendit të ditës, të mbarojmë...Përveç 3, 4 pikave të para kemi dhe shumë pika të tjera, na duhet kohë.

Z.Arjan Isufi – 3100lekë/vjetra ...është trajtim dinjitoz , siç e tha drejtoresha..?! Ju thatë , mund ti çojmë drejt tregut të punës, konkretisht..

Znj.Irena Stasa – I drejtohem Zyrës së punës. Këtu zbatojmë kriteret me një formulë që ka kaluar në parlament. Do të bëhet një studim më i thellë, strategji e ndihmës sociale. Jam e bindur që kjo masë do të rritet.

Z.Illir Aliaj – Dixhitalizimi, solli dhe disa të mira. Në momentin kur nuk ka patur sistem, kishte familje të punësuar, me vila 2-katëshe dhe merrnin ndihmë ekonomike. Dixhitalizimi nuk ka abuzivitet, i nxjerr nga skema , ata që kanë mundësi të mira. Është i pamjaftueshëm, por nuk vendos Bashkia Vlorë.

Z.Grigor Dede - Është diskutuar në mbledhjen e komisionit, zbatohen vetëm kriteret.

Dixhitalizimi është mjaft efikas. Për vlerën e ndihmës ekonomike, jemi shumë të ndjeshëm, të gjithë duam që të rritet. Rritja e fondit do të reflektohet nga drejtorja. Them ta kalojmë në votim.

Znj.Brikena Puka – Doja të shtoja , as 3 mijë lekë dhe as 9 mijë lekë , nuk do të mjaftonin , por ajo që bëjmë ne në organizatën tonë, ne duhet të nxisim që njerëzit mos të mjaftohen me masën e ndihmës ekonomike. Ka që nuk duan të punojnë , por të gjejnë mënyrat për ti nxitur për punësim.

Znj.Liljana Breshani – Dinjitet është ta nxjerrësh lekun me djersë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim.

Pro, të gjithë – 44 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 10/3, datë 31.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për dhënie të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin qershor 2023”. Një relacion nga administrata .

Znj.Irena Stasa – Pika tjetër është një pjesë e grandit nga qeveria , me pikë të pamjaftueshme. Të gjitha këto familje përfitojnë nga fondi i kushtëzuar. Përfitojnë 16 familje.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Pro , të gjithë - 44 vota.

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 10/4, datë 31.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për ndryshim në VKB-në Nr.87, datë 23.12.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara 2023” i ndryshuar”. Nga administrata ?

Znj.Laura Brinja/Drejtores e Burimeve Njerëzore –Është zbatuar VKM Nr 328, e muajit maj 2023, si dhe një shtesë për numrin e punonjësve, për shërbimin e varrezave të qytetit dhe dëshmorëve në shërbim pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike . Kemi pasqyruar rritjen e pagave, sa ishte dhe sa është, rreth 7% në të gjitha pozicionet. Bazuar dhe në ligjin për vetqeverisjen vendore , është e drejta e këshillit bashkiak për këtë miratim.

Z.Ermal Dredha – Lidhur me këtë projektvendim ...do të kërkoja ndihmën tuaj për të vazhduar dhe bërë punë të mira , që të përmirësohemi...Që nga dita e parë, problem ka qenë menaxhimi i varrezave publike dhe dëshmorëve. Janë bërë 3 procedura prokurimesh, kanë dështuar. Fakti që ka çeduar, s’mund ta lëmë ashtu.

Është pasqyra e qytetit. Në çdo vend varrezat janë model. S’kemi kohë të zgjatemi me procedurat , por të marrim masa sa më shpejt . Jemi 6 muaj deri në fund të vitit, së bashku ta rregullojmë. Bashkë jemi dhe më vonë , do ta diskutojmë përsëri.

Znj.Elca Bezhani – Komisioni i financës dhe këtë projektvendim e pa me vëmendje . Përsa i përket bazës ligjore, për vetqeverisjen vendore , ne jemi në rregull..Lexon ,pika “c”... Kjo gjë është paraqitur, duhej korrigjuar me nenin 54 , i cili thotë ...lexon...

Lidhur me sa citova këto projektvendime , drejtorja e burimeve njerëzore dhe Drejtorja juridike të jenë të kujdesëshme me bazën ligjore.

Gjithashtu projektvendimet, duhet të kenë firmat e drejtorëve. Me rritjen e pagave jemi dakort, është bazuar në VKM Nr 328 . U diskutua klasa 3B. Anëtarët e komisionit ishin dakort, por drejtoresha e burimeve njerëzore, nuk ishte dakort , pra duhet të kishim një relacion të detajuar . U la detyrë të rishihet për buxhetin e vitit 2024.

-Për pikën e sektorit të mirëmbajtjes së varrezave , do të ishte mirë të vinte si pikë e veçantë, por kjo është shumë emergjente dhe ne si komision dhe me nivelin e rritjes së pagave. U la detyrë që punonjësit të mërren me kritere, për ta bërë sa më mirë këtë punë.

Z.Atird Hoxha – Ligji Nr 139/2015....lexon ..Anëtarët nuk mund të përfshihen në vendimmarrje kur kanë të punësuar Me sa shikoj unë këta të PS duhet të kenë me dhjetra punonjës në Bashkinë Vlorë. Pra, të ngrihet këshilltari që nuk mund të votojë , kush ka familjar

e ka të ndaluar me ligj , deri në shkallën e dytë të afërsisë ...është shkelje ligji .

-Për këtë projektvendim, , në mbledhjen e komisionit kërkuam numrin total të punonjësve të bashkisë,së bashku me ndërmarrjet në varësi.

Ne kemi kërkuar dhe një relacion , të ishte sot në rendin e ditës në lidhje me zjarrin tek fushë grumbullimi i mbetjeve. Shkaqet, çfarë masash u morrëndhe me një të rënë të lapsit të miratojmë këtë numër punonjësish. Paraprakisht verifikoni, ndalimin e këshilltarëve për të votuar.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Relacioni është gati. Do ta trajtojmë tek pika të ndryshme. E kemi diskutuar me kryesinë.

Z.Atird Hoxha - mendoj se ka shumë punonjës që kanë rritje rroge qesharake, dhe në lidhje me gjendjen e varrezavePse nuk është bërë deri tani , gjendja e varrezave është shumë e keqe. Çfarë masash ...

Z.Ervis Moçka - Ky diskutim është shumë i drejtë dhe kryetari i bashkisë e dha arsyetimin e duhur dhe, ne duhet të japim një zgjidhje. Pra, është menduar dhe ka ardhur ky material. Tju themi dhe qytetarëve që , sot të marrim një vendim dhe numrin e 22 punonjësve, brenda ndërmarrjes së shërbimeve publike. Ti japim zgjidhje, pastaj më vonë të ngremë komision...Pra, është mënyra më e mirë për të miratuar këtë projektvendim për të ndryshuar faqen e varrezave.

Z.Atird Hoxha - Për procedurë, ka rregullore. Të respektohet.

Z.Ilir Aliaj - Nuk dua të shtoj më tepër nga ju , por propozimi që bëri kryetari i bashkisë, për 22 persona, janë të pamjaftueshëm. Të rishikohet numri i punonjësve. Menaxhimi i varrezave me 22 persona do të zgjasë shumë. Meqenëse, prekët dhe rastin e zjarreve, ra zjarr dhe pranë varrezave dhe, po të mos ishin marrë masat në kohë Mendoj që 22 persona janë të pamjaftueshëm.

-Pagat e administratorëve të rajoneve dhe administratorëve të njësisë duhet të unifikohen. Përsa i përket mbetjeve që u dogjën dhe ra zjarr, ishte shqetësim shumë i madh, por gjendja është përmirësuar. Me fillimin e Landfilldit , do të ndryshojë gjendja.

Z.Atird Hoxha – Rregullorja, flitet 1 pro, 1 kundër. Për procedurë. E thashë si shqetësim , psi e ngritën në konferencën e kryetarëve, të na vinte një relacion , është për qytetin. Meqenëse, fusha digjet brenda muajit dy herë, pra, kush është përgjegjës. Arsyet pse u dogjën ,,varrezat, ju i keni administruar. Kanë lidhje me qytetin. Landfilldi është pjesë e ceneratorëve, janë shpenzuar mijëra lekë.

Znj.Liljana Breshani – Zjarre bien kudo.

Z.Atird Hoxha - Flisni me radhë.

Z.Ermal Dredha - Vij për ti shërbyer komunitetit, Vlorës sonë. Përsa i përket zjarrit...po dal jashtë rendit të ditës.

Kemi bërë një relacion të shkurtër. Janë probleme të mbartura. Tymi ishte shqetësim shumë i madh. Që pas tymit të parë, kemi punuar 48 orë, non stop. Është punuar dhe menaxhuar...Sjam as prokuror...Unë si qytetar , them që, zjarri është i qëllimshëm. Përsa i përket angazhimit tim...Kemi qenë non stop...Aty ka 30 vjet që hidhen mbetje..Deri në 3 korrik është menaxhuar nga të tjerë. Është bërë punë sa për 1 vit bashkë. Janë përfshirë gjithë institucionet. Ka një fenomen, gjithë punonjësit do ti dalin vet zot, kush bën punën ...Të thoshit “bravo” si e menaxhuat, kemi punuar dhe, ngado ka zjarre. Them se është menaxhuar mirë. Dua të dalë fajtori. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm. Zjarri nuk lindi nga hiçi. Në momentin që do të gjendet personi përgjegjës dhe do të merren të gjitha masat. Kjo, them që, nuk do të ndodhë më ,

Gjithësecili do të bëjë punën. Kemi përgatitur dhe relacion.(Lexon relacionin) Datë 21 korrik . Njoftohemi nga policia bashkiake për zjarr. Menjëherë janë marrë masa nga zjarrfikësja dhe ndërmarrja e shërbimeve publike.

Datë 22 korrik , një tjetër zjarr....prapë zjarri , por jo nga hiçi...Ka qenë apo jo e qëllimshme. Ka pasë angazhime. U morrën masat, u përgjigjën shumë biznese të qytetit, si rrjedhojë, është mbuluar një pjesë shumë mirë. Thojini dhe punët e mira që bëhen.

Datë 22 korrik, kryetari i bashkisë dhe prefekti , kemi bërë thirrje për ndihmë për shuarjen e zjarrit, nga toka dhe ajri. Ka pasur prezencë të shtuar të bizneseve . Ju jam shumë mirënjohës. Ka shumë për të përmirësuar. Ku ka çeduar i gjithë procesi deri në datën 3 korrik...Tu përmirësohen kushtet atyre që luftuan me zjarret. Ky proces ka zgjatur disa ditë në vendgrumbullimin e mbetjeve...Kanë ndikuar temperaturat e larta si dhe prezenca e erës. Është situatë 30 vjeçare. Mendoj se, është e qëllimshme.,gjithashtu prezenca e gazit metan. Ky proces është monitoruar nga bizneset dhe nga kryetari i bashkisë. Do përpiqemi të mos përsëritet më. Do të menaxhohet më mirë. Landfilli si projekt, është i mbaruar, por me komunikimin që kam pas, jam besimplotë që ky problem do të marrë zgjidhje. Jemi të gjithë për të mirën e qytetit.

Faleminderit.

Z.Atird Hoxha – Bazuar tek rregullorja, neni 72....kam vetëm diçka. Punonjësit e bashkisë që sakrifikojnë...,ju vazhdoni të punoni...Ditën që është kërkuar zjarrfikësja .., zjarrfikësja duhet të ketë një pozicion të aksesueshëm, duhet kohë që të dalë. Në të dyja anët , zjarrfikësja mezi del.

Z.Ermal Dredha - Keni shkuar në vend, çfarë është bërë , si qytetar ?

Z.Atird Hoxha – Po, tymi është më pak...por vazhdon digjet akoma.

Z.Klodian Xhyheri - Në konferencën e kryetarëve kërkuva, ...minimumi që, qytetarëve tju jepej një relacion. Nuk ju akuzoi njeri, por një informacion ne e donim. Ka zjarrvëniet të qëllimshme mendoj dhe unë...por po ju lexoj njoftimin e Bashkisë Vlorëlexon..për shkak të temperaturave të larta...Këtë do ta nxjerrin organet hetimore . Është çështje shumë sensitive, rrezikohen qytetarët. Relacionin e kërkuam ne si opozitë. Nëqoftëse, ky problem qenka i mbartur, PS ka qenë në fuqi. Duam të sqarojmë qytetarët.

Znj.Elpinqi Mërkuri - Situaata është shumë e ndjeshme për të gjithë. Kryetari i bashkisë ka qenë non stop, në krye, për shuarjen e zjarreve.

Z.Gjergji Nika – Po i përfshij...Pjesa e zjarreve, e gjithë situata dhe gjendja tregoi paaftësi për menaxhimin e zjarrit. Unë mendoj që me ndryshimet klimatike, duhet një iniciativë , urgjent nga bashkia për heqien e zjarrfikëses nga ai vend. Të jetë më e aksesueshme, veshjet, pagat e tyre janë qesharake. Ky menaxhim për 30 vjet. Po ti futemi një analize të thellë, me çdo fond dhe pagesë.... Po të shohim fondin për televizionet..., janë shumë më të larta se këto paga Nëqoftëse, duam tju paraprijmë fatkeqësive , prioritet të jetë departamenti i zjarrfikëses. Duhet të shtohet stafi...pjesës së rrogave, sigurimeve shoqërore, janë rritur 40%. RRitja 7% për pagat e bashkisë , është qesharake. Pagat e specialistëve duhet të rriten. Duke rritur këto paga, mund të ulësh dhe numrin e punonjësve. Ku është abuzuar..., ku kanë shkuar fondet ...Është problematikë shumë e madhe.

Ky fond , edhe për rritjen e vlerës së ndihmës ekonomike, të ulen shpenzimet për televizionet etj.

Z.Grigor Dede – Kemi rritjen e pagave, pra këshilli bashkiak, reflekton VKM. Diskutohet për zjarret..., por ky projektvendim , në 70-75%, janë ata punonjës që punojnë me orar, pa orar .., të përfshihen dhe në këto problematika të zjarreve. Them dhe për pagën e policisë bashkiake. Po

diskutojmë këtë projektvendim, ti kthehemi rendit të ditës. Duhet të përgëzojmë ndërmarrjen e shërbimeve publike, zjarrfikëset, policinë bashkiake. Janë disa kategori që nuk e përfitojnë këtë rritje si policia bashkiake, paga e kryetarëve të rajoneve ndryshon nga ajo e administratorëve të njësisë, klasa 3B

Znj.Laura Brinja - Referencat ligjore...Në projektvendim, janë vendosur referencat ligjore të kryetarit të bashkisë, bazuar dhe në nenin 54Për krijimin e ndërmarrjes që duhet relacion, kjo nuk është ndërmarrje, është sektor në ndërmarrjen e shërbimeve publike. Relacioni final është brenda.

Referuar pagave të administratorëve të rajoneve, janë 5 njësi administrative. Rajonet janë pjesë e njësisë administrative. Ata marrin maksimumin dhe u është bashkëngjitur diploma dhe vjetërsia. Ndërsa për administratorin e njësisë, është paga bruto, pa asnjë shtesë.

Paga e policisë bashkiake - Në vendimin e qeverisë, vjen me një lidhje të veçantë , ku nuk pati ndryshime në këtë VKM.

Znj.Elca Bezhani – Kur bëra analizën dhe relacionin ..unë jam shumë e qartë, që s'është drejtorja e burimeve njerëzore për të bërë rritjen e pagave . Është drejtorja e financës. Drejtorja e burimeve njerëzore bën kategorizimin klasës dhe jo analizë të thelluar. Drejtorja e financës duhet të bëjë një prononcim, sa është fondi..Qeveria ka dhënë dhe një grant, një fond. Jo të kalojmë limitin.

Z.Hiqmet Haxhaj /DFBK – Përsa i përket problemit që shtron kryetarja e komisionit të financës., është vendim i qeverisë, kjo reformë në Bashkinë Vlorë ka marrë nw analizw pwr ta pasqyruar sa mw saktw.Në vednim kemi pasqyruar fondin e pakushtëzuar ..Qeveria në transfertën e pakushtëzuar ,parashikuar

- 19 milionë lekë, për administratën, ndërmarrjet në vartëse,

Pagat specifike (arsim, zjarrfikëse .. Po të shohim shpenzimet, pagat bashkë me shërbime të tjera, 20 milionë lekë, (bordi i kullimit)

-Total – 19 milionë

Granti i pakushtëzuar – 20 milionë pagat dhe 3 milionë sigurimet shoqërore.

Pra gjithë fondi i VKM është pasqyruar në rritjen e pagave, 51 milionë 160 mijë lekë .

Ka patur kursime fondesh nga pagat e papërdorura dhe nga fondi i sigurimeve shoqërore. I gjithë fondi është përdorur për paga dhe sigurime shoqërore

Znj.Elpinqi Mërkuri – Faleminderit. Zoti Geron merr fjalën.

Z.Geron Gunbardhi - Një pjesë e mirë e juaja , ishte dhe 4-vjeçarin e kaluar . Në komisionin e ekonomisë , kemi patur bashkëpunim shumë të mirë . Ti themi punë të mbarë kryetarit dhe turp atij Landfilldi. Që kjo të kishte gjithë infrastrukturën e nevojshme, në lidhje me vënien e zjarrit. Duhet të themi, çfarë kemi bërë, pse su vu në punë Landfilldi. Duhet të bëjmë një analizë , pse nuk vihet në punë Landfilldi.

-Për ndërmarrjen me 22 veta, të bëhet sa më parë. Në komision u vendos dhe një pikë,ky sektor të ketë zyrë dhe të ngrihet një komision që të monitorohet, qoftë dhe nga një grup këshilltarësh.

Pra, në komisione të vijnë gjërat më të qarta. Të ecim përpara dhe vërrejtjet le të bëhen.

Z.Ermal Dredha – Nuk i ka paguar bashkia. Është projekt i KWF, supervizimi etj.

Z.Ervis Moçka - U diskutuan 2 projektvendime brenda një pike, si dhe problematika e zjarrit.

Pavarësisht debatit politik, dhe opozita janë të ndjeshëm në lidhje me rritjen e pagave dhe shërbimit të zjarreve. Le të bëhet një analizë..... të mbarojnë procedurat , ndërkohë menaxhimi me vajtjen e kryetarit , pa teknikë, nuk mund të themi , sa kohë do të shuhet zjarri.

Për pagat , komisionet përkatës, kanë të drejtën të thërrasin drejtorët përkatës. Pra, që gjithë relacioni, debati të bëhet në komisione dhe dalin me propozime konkrete.

Si grup mendoj ta votojmë këtë projektvendim si ka ardhur dhe, në fund të vitit , kur të vijë buxheti të rishikohen dhe të vendosim.

Z.Arjan Isufi – Landfilldi është drejt përfundimit..personat që e menaxhojnë .Ka një zgjidhje, ekziston një agjenci eadministrimit dhe konfiskimit të pasurive...administratori , agjencia administron pasurinë.Mendoj që bashkia të ulet të flasë me ta, marrëveshja që mund të bëhet me administratorin,duke grumbulluar plehrat atje.I lehtësojmë punën ndërmarrjes së shërbimeve publike, jemi në kushtet e emergjencës.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votë.

Z.Atird Hoxha – Kushtet e pengesës, ligji nr 139/2015,lexon... këshilltari nuk mund të votojë

Znj.Elpinqi Mërkuri – Votohet.

Pro – 32 vota

Kundër – 5 vota

Abstenim – 2 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 10/5, datë 31.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për disa ndryshime në VKB Nr 1 , datë 18.01.2023 “Për buxhetin e Bashkisë Vlorë”.

Z.Daut Zëraj - Është VKM Nr 328 /2023, për rritjen e pagave. Me një vendim të këshillit bashkiak , pastrimi i qytetit i ka kaluar ndërmarrjes së shërbimeve publike. Shërbimi i varrezave publike dhe dëshmorëve, i kalon ndërmarrjes së shërbimeve publike, është bërë analizë. Fondi i sektorit të sapokrijuar ishte parashikuar të bëhej me prokurim. Fondi i kalon ndërmarrjes së shërbimeve publike. Në buxhetin e vitit 2023, ishte parashikuar rikostruksioni i pallatit të sportit. Ky fond , u shpërnda në investime. Kanë qenë disa shpenzime të prapambetura , sipas vendimeve të gjykatës, bashkia duhet të bëjë këto pagesa. Në vendgrumbullimin e mbetjeve, meqenëse menaxhimi po bëhet nga ndërmarrja e shërbimeve publike, është një fond prej 10 milionë lekësh. Pak a shumë kjo është tabela e shpërndarjes së fondeve. Ndërkohë që rritja e pagave nuk ishte parashikuar në fondin e bashkisë , u pa nga administrata që rritja të bëhej , bazuar në VKM. Pra, rritej vlera sipas VKM nr 328. Por në buxhetin e vitit 2024 , do të shikohet. Rreth 10 milionë fonde të papërdorura. Një fond , 15 milionë lekë, mbetet për në pallatin e sportit.

Znj.Elca Bezhani – Edhe ky projektvendim, në komisionin e financës u trajtua. U bënë disa sygjerime dhe të reflektohen në zbardhjen e vendimit të materialit ...tek pika “a” pakësohet.... Pika “b” ...ti shtohet shuma...., të reflektohen këto në zbardhjen e vendimit për në prefekturë.

Për shpenzimet – 600 dhe 601, shpenzimet për pagat, nuk janë shpenzime operative.

Pra, ne si komision kërkohet relacion përfundimtar të investimeve të përealizuara.

(Bashkëlidhur relacioni i komisionit të financës)

Dua të theksoj nga diskutimet e ndryshme , propozimi i zotit Geron, në lidhje me buxhetin, sa ishte dhe sa është, si dhe asetet, inventari fizik i pronave të bashkisë Vlorë, jemi dakort.

Znj.Edlira Kapllanaj –Është një ogur i mirë dhe për investimet në arsim, arsimi ka shumë nevojë për ne si parlament. Ju kujtoj palestrën e shkollës “4 Heronjtë”.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Pro – 36 vota

Kundër - 5 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 10/6, datë 31.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e projekt-dokumentit për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024 - 2026”. Një relacion.

Z.Daut Zëraj - Programi buxhetor afatmesëm 2024 ÷ 2026, është projekt dokument fillestar , ku janë bërë disa parashikime afatgjata. Analiza në komisionin e financës , disa pasaktësi të ndryshme në buxhetin e vitit 2023, duhen reflektuar nga drejtoria përkatëse. Mbas miratimit të projektvendimit nga këshilli, do ti nënshtrohemi dëgjësave publike dhe më vonë, në muajin nëntor do të vijë ai përfundimtar. Në total , shkojnë 40 % pagat dhe 35% shpenzimet operative. Rakordimi do të bëhet në zbardhjen e vendimit të këshillit. Ky draft i është dërguar dhe Ministrisë së financave, të cilët e kanë parë këtë pasaktësi të fondit. Në vitin 2023, parashikohen fonde më shumë se në vitin 2024. Nga këshilltarët mund të ketë propozime të tjera, duke menduar se është projekt draft , mund të lindin diskutime të tjera.

Z.Gjergji Nika – Ishte një projektvendim që kaloi në unanimitet. Por u tha në komision që , materiale të tilla të vijnë jo 5 ditë para por, më shumë, 10 ditë që të kemi kohë të shohim materialet. Në kohën që mbaron mbledhja e parë, do të diskutohet dhe më vonë , derisa gjërat të rregullohen .

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Pro – 33 vota

Kundër – 1 votë

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 10/7, datë 31.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve”.

Z.Illir Nikaj/Përgjegjës,Sektorit Pyjeve dhe Kullotave – Bazuar në VKM nr 433/2016, për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave.... , është 11.200 ha sipërfaqe , plus 7150 pyje dhe kullota (verore, dimërore)...Ligji 57/2020, ku bazohet mbarështimi i pyjeve, pra Pylli i Sodës dhe Uji i Ftohtë...Ky plan menaxhimi është 10 vjeçar. Nuk mund të bëjmë asnjë veprim pa kaluar ky material.

Z.Atird Hoxha - Edhe në komisionin juridik, falënderues për sqarimin dhe përgjigjet, i shërben qytetit. Ka një non sens , ne do japim fond për shtimin e pemëve , pjesën e gjelbëruar ...Dua tju them që, në Triport janë akorduar 2”mostra”, anije që kanë një teknologji të vjetër, ato shkaktojnë ndotje të jashtëzakonshme. Unë kam sjellë 3 foto, (pishat e pyllit të sodës), pikërisht për thellimin e portit është hedhur rërë dhe kanë humbur pemët. Miliona lekë për të gjelbëruar pyllin e sodës...Unë mendoj që, puna e administratës së bashkisë ..

Z.Illir Nikaj – Zoti Hoxha, e ngritët si sheqtesim dhe ne kemi marrë masa.

Z.Illir Aliaj – Këtu u fol për një studim mbarështimi. Mungon harta me sipërfaqet e detajuara. Mendoj që, mund të ketë dhe sipërfaqe të tjera që nuk mund ti kemi përfshirë. Do kërkoja një relacion të detajuar në lidhje me këtë.

Z.Illir Nikaj - Tek sekretariati i këshillit kemi kaluar gjithë materialin,

-187 ha, sipërfaqe Pylli i sodës.

-384 ha , sipërfaqe Uji i ftohtë.

Ekspert – Pylli i sodës ka një standart...e kemi ndjekur në mënyrë të përpiktë pyllin e sodës.

Rëndësi të veçantë i kemi kushtuar detit, i cili ka hyrë 3m...

-Neve kemi një manual nga ministria e turizmit, është dokument me një afat për mbarështim.

Z.Illir Aliaj – Këto studio janë konsultuar me shefin e financës , mbase keni nevojë për fond.

Mos e fusim bashkinë tonë në ngërç, vetëm për punën e fondeve se, mbas miratimit nga ministria e turizmit , jemi të detyruar ta zbatojmë.

Z.Simo Petromilo – Në komisionin e bujqësisë e trajtuam, diskutuam për planin e menaxhimit Kume – Shushicë(Pylli i Sodës – Uji i Ftohtë)

Bëmë diskutime dhe vërrejtje. Instituti teknik, duhet të na paraqiste hartat , për të krijuar një ide më të saktë.

-187 ha, për plan menaxhimi ku përveç përfitimitPër të shmangur kakofoninë, ta shtyjmë për miratim për një mbledhje sa më të afërt. Jam dakort me ato që tha zoti Ilir.

Z.Ervis Moçka – Edhe ne si grup mendojmë ta shtyjmë këtë projektvendim.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Meqenëse këshilltarët duan ta shtyjnë këtë projektvendim....

Z.Ilir Nikaj – Buxheti prej 6milionë nga blektorët...Sektori nuk i ka mundësitë financiare.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Meqenëse jeni dakort për ta shtyrë, për më shumë informacion, për mbledhjen tjetër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 10/8, datë 31.07.2023

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjetllës Kanalizimeve midis:Bashkisë Vlorë, Bashkisë Himarë, Bashkisë Selenicë, dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”

DP / AKUM - Proçesi i organizimit ka filluar në vitin 2022. Janë 15 shoqëri. Kriter ka qenë afërsia gjeografike dhe numri i klientëve. Vlorë është e 14, e fundit është Tirana për tu rajonalizuar. Është një proçes që i ka dhënë frytet për mirë. Rastin e Lezhës (bashkimi i Mirditës, Kurbinit..) Energjia elektrike pa paguar , rroga pa marrë. Gjatë vitit 2022 i është dërguar kryetarit të bashkisë autorizimi për marrëveshjen...U nënshkrua në vitin 2022. Janë 2 nivele; nga

Këshilli mbikqyrës dhe Asamblea e ortakëve.

-51% qeveria

-Bashkia Vlorë 41% dhe dy bashkitë e tjera më pak se 5%.

Do ketë ristrukturim, në të gjitha ndërmarrjet, departament teknik...Çdo bashki do të ketë njësitë e veta. Kjo është pak a shumë ..

Z.Myzafer Elezi – Kemi diskutuar në komisionin juridik. Marrëveshja është e paplotë. Neni 2 ...furnizimi me ujë 24 orë. Në asnjë pikë , as në nenin 2 dhe as në nenin 4 , nuk thuhet furnizimi me ujë 24 orë. Qytetarët kanë probleme me ujin e pijshëm...Të pyesja hartuesit e marrëveshjes..... a ka ndonjë vlerë , që të propozojmë ta shikoni . A ka ndonjë fond, pasi dimë problematikat për furnizimin me ujë. Mundet që më vonë , mund të rritet çmimi i ujit. A ka ndonjë projekt në lidhje me furnizimin e ujit të pijshëm, me rrjetin. Për 10 vjet mos të ketë rritje të çmimit . Të hartohet një projekt për furnizimin e ujit të pijshëm dhe ta kthejmë për të sjellë një material më të plotë .

Z.Illir Aliaj – Në komisionin e shërbimeve , ne e pamë me vëmendje këtë projektvendim, pati sygjerime, kërkesa , por unë vë re , që nga fillimi deri në fund , opozita bën politikë që ta dëgjojë populli. Të merren më shumë me çështjet teknike. Ne votojmë pro. Unë mendoj se, kjo marrëveshje do ta shpëtojë popullin e Vlorës, siç është bërë shembull në gjithë bashkitë e tjera. Pika që ne kemi sot për të diskutuar , nuk është që do të marrë Vlorë ujë 24 orë apo jo, ne si bashki kemi 41%, luajmë rolin kryesor në administrim. Ky projektvendim, ka kaluar në këshillin

bashkiak të mëparshëm, AKUM-i injeh asetet..Në rast se, kjo shoqëri nuk funksionon mbas 3-4 vjetësh, si do ndahen asetet...Ne në komision e kaluam pa asnjë votë kundër.

Z.Ermal Dredha - Nga ana teknike, nuk i hyj. Për transparencë, ky material ka kaluar me VKB Nr 51/2022. Këshillat e tjerë e kanë kaluar. Për transparencë, drejtorja e ujësjellësit dhe ekipi që po punon, ujë Vlorë ka, por jo qytetari. Të jemi më të hapur në këtë pjesë. Kjo drejtori po kthehet në gropën e zezë për Bashkinë Vlorë. Ka shumë borxhe. Pra, ka nevojë për ndryshime shumë imedjate. Kemi bërë dhe takime të tjera me menaxherët e AKUM-it. Kjo marrëveshje është si garanci, është më shumë për efekte transparence , prandaj e sollëm në këshillin bashkiak.

Z.Atird Hoxha - Përsa i përket këtij projektvendimi, do tju kujtoja vetëm 1 fakt. Në qershor/2018 është paraqitur një projektvendim ,ku çmimi për m³ të rritej në 700 lekë...Në Novoselë – rritje 144%....,pra , nga sot me nesër , të paguhej vlerë e marammendëse.Në kundërshtimin tonë si opozitë, nuk do të rritej çmimi, por rritje të performancës...U thanë që do të rriteshin investimet...Por sot në 2023, e shoh servilizëm ndaj MIE.

Si do kemi menaxhim...51% MIE. Kjo nuk do ta rrisë performancën. Në vitin e parë këta zotërinj do të vijnë me propozimin për rritjen e çmimit të ujit.

Në lidhje me VKB Nr 51, ne nuk kemi asnjë informacion, çfarë do të kemi..Duhet të thuhet të gjitha. Kur këtu nuk thuhet asgjë , do ta shihni që kjo do të rëndojë në xhepat e qytetarëve. Vota ime është kundër . Nuk është mbajtur fjala që në qershor/2018, nuk u bë asgjë , nuk u rrit performanca..Sa është numri i punonjësve ? Vota ime është kundër .

AKUM- Vlorë është e fundit nga radha . Do të ketë ekspertë kontabël që vlerëson asetet. Do të transferohen në 30 shtator..Në datën 1 tetor fillon ..

Z.Atird Hoxha - Ka një akt marrëveshje...,thuajë që 10 vitet e para, nuk do të ketë rritje të çmimit të ujit.

Z.Shkëlqim Leskaj – Unë kam qenë pjesë e kësaj ndërmarrje . Është me shumë interes, ka problematika të mbartura në vite, por duhet të kuptohet që në Vlorë ka ujë për 3 qytete. Por rrjeti do investime të mëdha...Disa nga shifrat , të ardhura →37 ÷ 40milionë lekë
Pagat plus sigurimet shoqërore → 20 milionë, faturat e energjisë elektrike → 15 milionë lekë.

Bashkia Vlorë, ka çmimin më të ulët për m³ të ujit. Është ndërmarrje me vetadministrim...Kemi stacionet e pompimit, pikën e ujrave të ndotura, etj problem. Zona bregdetare që vuan mungesën e ujit. Mos ta shtyjme, por ta votojmë këtë projektvendim.

Z.Geron Gunbardhi – Dëgjova zotën Shkëlqim. Nuk e kuptojmë...kujt i drejtohem . Ne jemi pro për çdo gjë që sillni ju. Ku shkojnë këto miliona euro. Hajd të bëjmë një bilanc, sipas VKM, përgjegjësia është personale...Ujë ka plot dhe, ujë nuk ka .Ujësjellësi i Novoselës, linja e Kuzumbasë....?

Pra, 41% të kujt ...?

Jemi dakort që Vlorë të ketë ujë.

Z.Shkëlqim Leskaj - Në kohën që kam qenë unë, është bërë një tender për lagjen “Partizani” në Rajonin Nr 1..., është bërë tjetër, rrjeti tercial ..Vlorë ka ujë për 3 qytete. AKUM-i ta marrë për furnizimin sa më të mirë të ujit.Ujësjellësi Novoselë, nuk e di..

Z.Illir Aliaj - Për mos tu futur në këto detaje. Në këtë projektvendim, kemi për të krijuar një shoqëri tregëtare, Bashkia Vlorë, Himarë dhe Selenicë.

51% AKUM-i , e cila do mbulojë gjithë debitë e ujësjellësit të Vlorës. Kjo është një risi që po na

vjen , që qytetarët të jenë më të sigurt nesër. Prandaj, bëhet kjo marrëveshje MIE dhe 3 bashkitë. Z.Geron Gunbardhi - Çu bënë 10 milionë € ? janë marrë në dorëzim? Pastaj vazhdojmë.

Z.Ermal Dredha – Sa kohë jemi në ujësjellësin e Bashkisë Vlorë ,ujësjellës- kanalizime , janë 3 milionë lekë për OSHE; 250 milionë lekë, muajin koherent.

Situata është tepër alarmante, edhe pse me ndihmën e AKUM-it. Bizneset nuk paguajnë detyrimet, abuzimet ekzistojnë.

→51% AKUM dhe MIE...shok e miq

Zonja Elona, sa shkon borxhi ?

Znj.Elona Hodaj/Drejtoresha UK – 4 miliard lekë/vjetra, gjyqet e punonjësve etj...

Znj.Evis Allushi – Është një projektvendim shumë i rëndësishëm. Kjo akt marrëveshje do të jetë pozitive, për arsye të ndryshme...., humbjet në rrjet më të vogla, zvogëlim i debisë...Mendoj që në akt marrëveshje të bëhet një pikë , ku ti lihet një afat për shlyerjen e detyrimeve...Jam pro këtij materiali

Z.Klodian Xhyheri - Për shkak të decentralizimit....të vetqeverisjes ...citoj..Ujësjellësi ka ...edhe nga kjo fjali , ujësjellësi ose ka mangësi në menaxhim ose korrupsion. Para se të shkojmë në këtë marrëveshje, duhet të ngremë një grup ekspertësh , ku të bëhet një bilanc..U tha, është falimentuar, kredhur në borxhe ...Tu themi qytetarëve që kjo ndërmarrje ka falimentuar.Nuk e thatë që kemi fuqi për të furnizuar 300 mijë banorë. Nuk ka një strategji...plazhet nuk i administron bashkia...asgjë bashkia..Ku është ky decentralizim ?

Z.Ervis Moçka – po bëhet shumë politikë, me një fakt që e njohim. Të gjitha bashkitë kanë rritur tarifat...Normalisht të nisemi nga shërbimi .Zgjidhja është e lehtë. Kostua e shërbimit arrihet me rritjen e tarifës. Ndërmarrja e ujësjellësit, është subvencionuar në vite, por ska pas as ndryshime. Sot po diskutojmë marrëveshjen, pas një analize në 61 bashki, ku vendos të ndërhyjë financiarisht shteti me bashkitë. Ujësjellësi është në falimentim, pra ose do ta mbyllim ose ta ristrukturojmë. Të gjitha pyetjet gjejnë përgjigje në marrëveshje. Janë llogaritur asetet. 51% të aksioneve do të blihen , edhe borxhet Pas ekspertëve të licencuar që mbajnë përgjegjësi për firmat...MIE është e gatëshme për 51%.

Po investimet...Këto do të jenë pjesë e investimeve të 51%, pjesë të aksioneve.

Ka një problem. Nëqoftëse, tejkalon shumë kapitalin , MIE të thotë nuk të kërkoj shtesë.

Projektet në proces dhe borxhet ..Të gjitha borxhet , 41% nuk e mbulon plus investimet që.....

Për Bashkinë Vlorë, është shumë favorizuese.

Z.Geron Gunbardhi – Të dëgjojmë ekspertin.

Z.Illir Aliaj – Këshilli mbikqyrës, më shumë nga ne, nga Vlora në përbërje ?

-Po bashkia, 3 bashki , mënyra e të investuarit, ku ka nevojë më tepër ?

AKUM-i - 3 përfaqësues MIE plus 2 bashkia. Janë specialistë të fushës. E rëndësishme është të jenë kontribues në sektor. Investimet janë në proces. Çfarë tubacioni....? Është kontratë, është në proces. E njoh Vlorën, po punojmë në terren.

Z.Geron Gunbardhi – Kemi 3 investime të qeverisë, nuk kanë mbaruar.Ju do të investoni?

“x” milionë lekë që janë, do ta merrni, mbaroni ju ?

AKUM – Lagjia “Partizani “...

Znj.Elpinqi Mërkuri - Po diskutoni jashtë materialit.

Z.Atird Hoxha – Tha kryetari i bashkisë , për VKM Nr 51 , pra nuk dimë, çfarë është bërë, çfarë është negociuar. Nuk jemi të njohur me këtë vendim të këshillit bashkiak. Do të marrin 51% , vetëm për të shlyer borxhin..? Investimet imagjinare dhe shlyerjen e borxheve, vetëm me 51% ?

Z.Ermal Dredha - Janë në bilanc të reflektuara gjithë investimet. Është VKM.

Z.Atird Hoxha – Sanksionojë që sdo ketë rritje të çmimit të ujit.

Z.Ermal Dredha – Bashkia s'ka mundësi financiare. Menaxhimi nuk përballohet. Vlora ka çmimin më të ulët të ujit.

AKUM – 60% e kostos është energji elektrike. Plan biznesi e përcakton.

Z.Gjergji Nika – Gjithë analiza e këtij procesi ka kaluar. Është mbyllur në vitin 2022. Ne duhet të kishim të gjitha letrat, pra për në finale , duhet të shikojmë rrugëtimin. Unë kam marrë informacion nga këto qarqe që janë mbuluar.

→51% - AKUM dhe 49% - bashkitë.

→4 milionë lekë borxhe. Është keqmenaxhim. Por , si doni ta kaloni pa projekte

AKUM – Po bëhet studim për të mbuluar gjithë qytetin.

Z.Gjergji Nika – Analiza ime..të gjitha këto 15 kanë një total...Është bërë gati konçisionari.

Vlora e ka të pamundur të menaxhojë Selenicën. Por,AKUM-i, a mund ta menaxhojë më mirë ? Investimet janë shtetërore.

AKUM – Në Durrës, 8 milionë lekë /reja, në ditë arkëtoheshin. Në Vlorë, me grupin e taskë

forcës po punojmë.Z.Gjergji Nika – Administrimi...Ideja , është që, me krijimin e të resë.....por , do të jetë një mbyllje për tu hapur një tjetër.

Znj.Edlira Kapllani – Jam pjesë e komunitetit të lagjes “Partizani “, ku ka qenë problem dhe kam gjetur zgjidhje me ndihmën e drejtoreshës. Kush janë benefitet e këtij projekti ..Lexon ...(është koha për ndërhyrje...15 Sha..rajonale ..)– 51% ministria dhe 49% bashkitë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Pro – 32 vota

Kundër – 6 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 10/9, datë 31.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 8 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për kalimin nga përdorimi në pronësi të tokës bujqësore” znj.Lluiza Ligor Lati” Një relacion nga administrata ?

Znj.Sonela Haxhiraj /Drejtoreshë Dr. Aseteve – Objekti është kalimi nga përdorimi në pronësi të tokës bujqësore, të zonjës Lluiza Lati .
Dosja është dërguar nga Agjencia shtetërore e kadastrës dhe ka dokumentacionin e plotë . Për këto arsye e kemi sjellë për miratim në këshillin bashkiak.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim?

Pro – 39 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 10/10, datë 31.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën . të ndryshme.

Z.Sokol Kushta - Sot është data 31 korrik. Duhet të kishim një dokument në lidhje me Klubin e Futbollit “Flamurtari “. Do prisnim marrëveshjen e re.Nuk kemi afate. Kam një mendim, që “Flamurtari “ ose bashkia , duhet të nxjerrë në shitje aksionet. Vetëm në këtë formë zotit Idrizi, i jepetPjesa më pozitive e tij është pagesa që ka bërë.

2.Në lidhje me administratorët e pallateve..Administratorët janë 4, tu jepet një ndihmë ekonomike. Është shumë e nevojshme.

Z.Ermal Dredha – Ndërmarrja e pastrimit, duke informuar gjithë operatorët përgjatë bregdetit , ka njëfarë ndryshimi..Si qytetar , si kryetar bashkie dua dhe ndihmën tuaj , ndërgjegjësimit tuaj...koshat bosh dhe plehrat sheshit. Do të shohim si do ta bëjmë . Ju lutem të gjithëve për një ambient më të pastër.

Znj.Liljana Breshani – Në lidhje me aksin rrugor e Plazhit të vjetër – Zvërnec, 2 ura janë pa parmacë.

-Shërbimi publik, për këtë zonë , deri në Zvërnec. A kanë ndryshuar fashat e orareve , a është zgjatur orari dhe, deri kur ?

Z.Geron Gunbardhi – Kemi qenë opozitë shumë e fortë. Kemi diskutuar dhe kundërshtuar.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Faleminderit për diskutimet e bëra.